



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 41, datë 04.02.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL ME
QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) TË
GJYQ TARËVE QË KANË KALUAR ME SUKSES PROCESIN E RIVLERËSIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 89, pika 1 dhe 171, pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, 63 dhe 86, shkronja “dh” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, bazuar në Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021 dhe dosjet e dërguara në vijim nga organet e rivlerësimit, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

V E N D O S I :

- I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.
- II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:
 1. Për gjyqtaren znj. Altina Nasufi – Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Zeta Tërpollari.
 2. Për gjyqtarin z. Erjon Çela - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
 3. Për gjyqtaren znj. Vojsava Osmanaj - Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR